

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M
Nr. 3, datë 21.6.2006

PËR
REHABILITIMIN E SHTRETËRVE DHE TË BRIGJEVE
TË LUMENJVE, TË DËMTUARA NGA SHFRYTËZIMI I
INERTEVE

Në mbështetje të shkronjës “b”, të nenit 6, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”, dhe të pikës 2, të nenit 1, të ligjit nr 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Personat, fizikë e juridikë, që me leje shfrytëzojnë inertet në shtretërit e lumenjve, janë të detyruar të rehabilitojnë sipërfaqet e dëmtuara nga veprimtaria e tyre.

2. Rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve në shtretërit dhe brigjet e lumenjve është pjesë e veprimtarisë shfrytëzuese të tyre. Rehabilitimi parashikohet, planifikohet dhe realizohet njëkohësisht e krahas veprimtarisë shfrytëzuese, madje vazhdon edhe pas përfundimit të kësaj veprimtarie, deri sa sipërfaqja e shfrytëzuar të jetë rehabilituar plotësisht.

3. Plani i rehabilitimit të zonave të dëmtuara përmban projektin e rehabilitimit, afatet kohore për kryerjen e punimeve dhe kostot përkatëse.

4. Plani i rehabilitimit trajton, gjithashtu, masat e veprimet për sistemimin dhe përgatitjen e vendit të shfrytëzimit, për parandalimin e erozionit, për gjelbërimin dhe rigjelbërimin, si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme, për mirëmbajtjen e veprave inxhinierike, që ndodhen në zonë apo pranë saj.

5. Projektet e shfrytëzimit të inerteve lumore dhe projektet e rehabilitimit të zonave të shfrytëzimit hartohen nga institucione ose shoqëri, studimore e projektuese, të licencuara në fushën e mjedisit dhe të hidroteknikës.

6. Plan i rehabilitimit paraqitet në Këshillin e Basenit Ujëmbledhës, si pjesë e dokumentacionit për t'u pajisur me leje shfrytëzimi.

7. Në planin e rehabilitimit, veprimet rehabilituese që do të kryejë subjekti, jepen të ndara në vite, në përputhje me afatet e ripërtëritjes së lejes së shfrytëzimit.

8. Ripërtëritja vjetore e lejes së shfrytëzimit nuk bëhet nëse subjekti nuk provon, me dokumente, se ka realizuar detyrat e planit të rehabilitimit, të ngarkuar për vitin e kaluar.

9. Nëse gjatë ripërtëritjes së lejes vërtetohen rrethana, që kërkojnë rishikimin e planit të rehabilitimit apo kryerjen e veprimeve plotësuese për rehabilitimin e zonës që shfrytëzohet, ato vendosen si kërkesa të detyrueshme në leje, për t'u zbatuar në vitin në vazhdim.

10. Inspektorati i Mjedisit dhe Agjencitë e Ujit të Baseneve (AUB) ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme, për të garantuar zbatimin e planeve të rehabilitimit. Ata evidentojnë, sipas qarqeve, subjektet, që nuk zbatojnë kërkesat e planit të rehabilitimit, dhe, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, marrin masa ligjore, deri në heqjen e lejes së shfrytëzimit dhe paditjen në gjykatë, për dëmin e shkaktuar në mjedis.

11. Të dhënat për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe përfundimin e veprimtarive rehabilituese shënohen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga subjekti i licencuar dhe kryetari i basenit ujor përkatës. Pas këtij veprimi subjekti quhet se e ka dorëzuar në rregull sipërfaqen, që ka shfrytëzuar.

12. Subjektet, që kanë përfunduar veprimtarinë e shfrytëzimit të inerteve lumore dhe nuk e kanë rehabilituar zonën, që kanë dëmtuar, kanë detyrimin ligjor për ta rehabilituar atë, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

13. Planet e rehabilitimit hartohen në përputhje me çështjet dhe masat e përcaktuara në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Ngarkohen këshillat e baseneve ujëmbledhëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
SALI BERISHA

ZËVENDËSKRYETARI
LUFTER XHUVELI

SHTOJCË

ÇËSHTJE PËR T'U TRAJTUAR NGA PLANET E REHABILITIMIT TË SHTRËTËRVE DHE BRIGJEVE TË LUMENJVE DHE SUGJERIMI I MASAVE PËR REHABILITIMIN E TYRE

1. Hyrje

1.1 Përkufizim

Rehabilitimi përfshin të gjitha ato masa, të cilat synojnë të riparojnë shtretërit e lumenjve dhe brigjet e dëmtuara dhe t'i kthejnë ato në një gjendje të qëndrueshme, të përafërt me atë të parashfrytëzimit .

Rehabilitimi i mjediseve pas përfundimit të shfrytëzimit duhet të hartohet si pjesë përbërëse e të gjithë projektit të shfrytëzimit. Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve mbështetet në ligjin nr. 8093, datë 23.3.1996, "Për rezervat ujore".

Rehabilitim i zonës së shfrytëzuar nënkupton:

- Parashikimin dhe realizimin e masave të ndryshme restauruese në shtretërit e lumenjve, për një regjim normal i rrjedhës;
- Sistemimin e dherave apo të zajeve të trasha në ato vende, ku nuk ekspozohen në mënyrë të dukshme;
- Përcaktimin e vendit të depozitimeve mbetjeve teknologjike, për një rikthim të peizazhit në një gjendje të përafërt me atë të parashfrytëzimit;
- Shmangien e gropave apo të thellimeve në shtretërit e lumenjve apo në brigjet e tyre;
- Risjelljen e shpateve apo brigjeve në të njëjtat kushte, si para shfrytëzimit;
- Mbjelljen e bimësisë karakteristike të zonës;
- Ndërtimin e pritave apo të veprave të tjera mbrojtëse, aty ku është e nevojshme.

1.2 Objektivat

Synimet kryesore të punës rehabilituese janë:

- Arritja e stabilizimit të zonave të shfrytëzuara, për të minimizuar erozionin, përmytjet dhe dëmtimin e veprave hidroteknike.
- Minimizimi i ndikimit pamor të zonave të dëmtuara.
- Mbrojtja e drejtpërdrejtë e objekteve të rëndësishme, ekonomike e shoqërore.

2. Projekti i rehabilitimit

Rehabilitimi kërkon një studim të plotë mjedisor, ku të ndërthuren elementet biologjike me ato inxhinierike, për të bërë të mundur ruajtjen e shpejtësisë natyrore të proceseve fizike, kimike dhe biologjike, të dëmtuara.

Projekti të hartohet nga një grup ekspertësh të licencuar dhe duhet të përmbajë:

1. Qëllimin dhe zgjidhjet e mundshme të projektit;
2. Të dhëna për objektin, si sipërfaqja, vendndodhja etj;
3. Kohën e parashikuar për kryerjen e punimeve, të cilat grupohen në dy lloje:
 - a) Punime biologjike, sipas kritereve të pyllëzimit dhe riaktivizimit të botës së gjallë;
 - b) Punime hidroteknike, të miratuara nga institutet përkatëse.
4. Vëllimin dhe vlerën e përafërt të punimeve, veçmas për ato biologjike e veçmas për ato hidroteknike;
5. Një plan monitorimi; me detyrat specifike.

Gjatë ripërtëritjes së lejeve, në bazë të vlerësimit të dëmtimit evidentohen masat që duhet të merren. Kur dëmtimi është:

- a) i shkallës së ulët, përmban:
 - shpërndarjen e sedimenteve.
 - pyllëzimin e zonës së shfrytëzuar.
- b) i shkallës së lartë, përmban:
 - transportin dhe shpërndarjen e sedimenteve.
 - rehabilitimin e regjimit të rrjedhës.
 - rehabilitimin e brigjeve.

2.1 Sistemimi i vendit, ku është kryer shfrytëzimi

Pas përfundimit të veprimtarisë: merren këto masa:

- Largimi i pajisjeve, makinerive, për ta risjellë të gjithë zonën e shfrytëzuar në kushte sa më të përafërta me peizazhin e para dhënies së lejes.
- Largimi ose sistemimi i mbetjeve të depozituara gjatë shfrytëzimit.
- Prishja e çdo objekti të ndërtuar gjatë shfrytëzimit të zonës.
- Risjellja e shpateve apo e brigjeve në të njëjtat kushte, si para shfrytëzimit, që do të thotë ruajtja e konfiguracionit.
- Mbjellja e bimëve karakteristike, duke u dhënë përparësi bimëve

autoktone, që kanë qenë para shfrytëzimit, dhe e bimësisë, që i përshtatet tipit të tokës, për të fuqizuar shpatet dhe parandaluar erozionin.

- Ndërtimi i pritave, mureve apo veprave mbrojtëse, kur është i nevojshëm dhe i përcaktuar në projektin hidroteknik.

- Sheshimi ose riparimi, dhe kur është e domosdoshme edhe sigurimi i rivegetacionit, i të gjitha zonave, të përdorura për trafik.

- Shmangia e gropave apo e thellimeve në shtretërit e lumenjve.

3. Proceset që përcaktojnë suksesin e planit të rehabilitimit

Për të përcaktuar suksesin e një plani rehabilitimi duhet të trajtohen disa elemente, si:

a) rehabilitimi i shpërndarjes së sedimenetev, duke:

- i shpërndarë ato në vend ose duke i transportuar.
- riparuar apo ndërtuar vepra hidroteknike.
- rritur sipërfaqen e zonave me vegetacion.

b) rehabilitimi i regjimit të rrjedhës së ujit, duke:

- zbatuar teknika për zgjerimin e pasqyrës së ujit.
- pakësuar tërheqjen e ujit ose shpërndarjen e tij mbi normat, psh për

ujitje.

- ruajtur nivelin e ujërave nëntokësore.

c) rehabilitimi i cilësisë së ujit.

Në rast se janë identifikuar probleme në cilësinë e ujërave, atëherë rehabilitimi i cilësisë së ujit merr përparësi në krahim me të gjitha masat e tjera (duhen respektuar normat e Direktivës Bazë të Ujit, të BE-së, dhe të legjisllacionit vendas).

d) rehabilitimi i botës së gjallë, në dy drejtime:

- Rehabilitimi i habitateve për faunën e egër (shpendë, zvaranikë, amfibë, etj)

- Ripopullimi me rrasat peshqish, autoktonë të lumenjve.

DREJTORIA E POLITIKAVE TË MBROJTJES SË NATYRËS